

ARNAVUTÇA ÖZETLEMELER
ALBANIAN SUMMARIES
PËRMBAJTËT NË SHQIP

Anila SHEHU POLAT*

Alevilik-Bektaşilik Araştırmaları Dergisi bu sayısında yer alan makale ve araştırma yazılarının Arnavut okuyucular için kısa bir özetlemesini yaparak, onların da dergimizin içeriği ile ilgili az da olsa bir bilgiye sahip olmasını, gerektiğinde geniş çeviriler yapmalarına zemin hazırlamak istedik.

Për lexuesit shqipfolës të Revistës Studimore Alevizmi-Bektashizmi kemi përgatitur nga një përmbajtje të shkurtër në Shqip për të gjitha shkrimet dhe studimet e përfshira në këtë numër, sepse mendojmë që në këtë mënyrë mund të krijojmë një ide sado të vogël përreth përmbajtjes së kësaj reviste dhe kështu duam të krijojmë dhe ti hapim rrugë mundësisë që në rastet e nevojshme të bëhen më shumë përkthime

**FISËT DHE OXHAQËT NË ANADOLLIN JUGOR DHE LINDINDOR NË
PERIUDHËN E VENDNUMËRIMIT DHE PRAPAMBETJES II.**

Alemdar YALÇIN¹

PËRMBLEDHJE

Në këtë studim është përqëndruar në historinë kronologjike të Oxhaqeve dhe Fiseve që gjendeshin në Anadollin Jugor dhe Lindor në periudhën kur Perandoria Osmane ishte në fazën e Vendnumërimit dhe Prapambetjes. Përveç kësaj në këtë studim janë marrë në dorë edhe shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve sociale, politike dhe historike që nxitën njëra tjetrën dhe zgjatën deri në shekullin e 21-të. Me anë të kësaj pikëpamje të shumëfishuar, në sajë të të dhënave akademike dhe të dhënave të marra nga boshtet studimore jemi përpjekur që në këtë artikull të pasqyrojmë nga pikëpamja historike konceptet e Alevizmit dhe Fiseve në Turqi.

1 * Prof. Dr. Anëtar në Fakultetin e Edukimit në Universitetin Gazi, Ankara/Turqi, mayalcin@gazi.edu.tr

Në këtë studim u është dhënë vend të gjithë hisorianëve të njohur si Historia e İsmail (Ismail) Asım (Asëm) Efendi dhe Historia e Raşit (Rashit) që kanë studiuar ngjarjet në Lindje dhe Jug Lindje të Anadollit. Por duhet të përmendet që Histroia e Ahmet Cevdet (Xhevdet) Paşa (Pasha) ka një rëndësi të veçantë.

Të dhënat e përpiluara në artikullin e parë të serisë si edhe në artikulin në dytë në shumë raste janë pasqyruar si citime kurse pjesa tjetër është përpiluar si bibliografi e zgjedhur. Librat, artikujt dhe të dhënat që gjenden në pjesën e bibliografisë përpëjnë edhe themelin e pikëpamjeve që shprehen në këtë artikull. Është e rëndësishme që brezave të rinj t'ju tranmentontohen saktë dijet që kanë lidhje me këtë teme, me qëllim që ata të mund të arrijnë të dallojnë të gjitha këto pika të ndërthurta dhe pikëbashkime. Në ditët e sotme zakonisht kërkohet që të harrohen dhimbjet që janë kaluar në Anadoll në 400 vitet e fundit. Harresa, mund të vlerësohet si e dobishme për të larguar efektin e dhimbjes e shkaktuar në të shkuarën. Por nga ana tjetër, bushja e hendeqeve me njohurri të rreme dhe të gabuara bën që të krijohen probleme të rëndësishme gjatë procesit të riformimit të shoqërisë tonë dhe bën të mundur e nxjerrjes në pah të konflikte artificiale. Prandaj dhe duhet të dihen mirë dhimbjet e ardhura nga katërqind vitet e fundit pasi ka rëndësi jetësore e nxjerrjes e mësimave nga e shkuara.

Fjalet Kyçe:

Fise, Oxhak, Kokëkuçët (kızılbaş), Heretik, Historia Osmane, në Mërgim, Strehim, Kryengritje.

NDËRTIMI I IDENTITETIT TË NJË DERVISHI HETERODOKS OSE KALIMI NGA VEFAË NË ALEVIZËM: MBI SHEHUN ÇOBAN DHE BIJTË E TIJ

Sadullah GÜLTEN²

PËRMBLEDHJE

Emri i Shehut Çoban është rastisur për herë të parë në veprën (Menakıbname) ku flitet për mrekullitë dhe jetën e Ebu'l-Vefa Bağdadî (Baadadi) i cili është themeluesi i Tarrikatit Vefâi (Vefai) dhe si shumë dervish që nuk janë synni ngel nën hijen e prijësve të tij. Ai, ashtu si të gjithë dervishët e tjerë heterodoks ka vepruar në bashkpunim me Fisin dhe besimtarët e tij dhe është vendosur në Sivas dhe në faltoren që kanë ndërtuar kanë vazhduar misjonin e tyre. Sundimtari i Selçuk-ut, Gıyaseddin Keyhüsrev (Gëjaseddin Kejhysrev 1266-1284) me qëllim që të marri mbështetjen e Sheh Çobanit e futi faltoren në grupin Shoqatave dhe kështu mundësoi siguriminë finansive të nevosjshme për shpenzimet. Bashkë më ndihmën që mori nga shteti rajoni ku ndodhej faltorja u bë një nga lagjet më të rëndësishme të Sivasit, kurse dervishtë të futur në shoqatë u bënë pjesë e shoqërisë së qytetit. Nga ana tjetër si pasojë e shpërndarjes së pjesëtarëve të tjerë të fisit dhe të nxënësve të tij të cilët u vendosën në vende të ndryshme të Anadollit Shehu arritti të shndrohet në një kult të rëndësishëm për Tyrkmenët, prandaj dhe në emër të tij janë ndërtuar vende vizitash dhe tyrbe në shumë qendra. Nga këto tyrbe përveç tyrbes së Sheh Çobanit në Sivas mund të përmendim edhe atë në Fshatin Çobanlı (Çobanllë) që është në vartësinë e qytezës Gölova (Golova) në rrethin e Sivasit, atë që ndodhet në qytezen Mazgrit në rrethin Tunceli (Tunxheli) si edhe Tyrbja e Sheh Çobanit në Hasankeyf (Hasankejf). Në sanxhakët Niğde (Niide), Hasankeyf (Hasankejf), Aksaray (Aksaraj), Çemişgezek (Çemishgezek në Tunxheli) dhe Karahisar-ı Sahip ndodhen Faltore kurse në sanxhakët Hasankeyf, Niğde, Tokat, Urfa dhe Kastamonu gjenden fshatra me emrin “Sheh Çoban”. Duke qenë nën dikimin e këtij kulti të formuar pranohet sikur është themeluesi i oxhakut Alevian i me emrin Sheh Çoban që ndodhet në qytezën Mazgrit të rrethit Tunceli (Tunxheli). Prandaj dhe tema e këtij studimi është çvendosja e Sheh Çobanit në Anadoll, përqëndrimi i tij në Sivas dhe se si u përhap nëpër Anadoll kulti i Sheh Çobanit dhe ndërtimi i tyrbeve, faltore-

² Doç. Dr., Universiteti Ordu, Dega e Historisë

ve, lagjeve dhe fshatrave me emrin e tij dhe se si Shehu Vefâî pranohet si themelues i Oxhaqeve Aleviane. Sërisht duke u nisur nga oxhaqet e Sheh Çobanit do studiohen emrat e oxhaqeve aleviane që ndodhen në Anadoll dhe se si janë ndikuar ato. E gjithë kjo është bazuar në veprën (menakıbname) e Ebu'l- Vafa dhe në regjistra.

Fjalët Kyçe:

Sheh Çoban, Ebu'l – Vefa, Vepër (Menakıbname), oxhaku Alevian, Tunceli, Sivas, Teqe e vogël, Tyrbe, Regjistër.

ERQANNAMEJA HACI (HAXHI) BABA KIRZADE (KËRZADE) HÜSEYİN (HYSEJIN) HÜSNÜ (HYSNY)

Cem ERDEM³

Ersoy TOPUZKANAMIŞ⁴

PËRMBLEDHJE

Erqannamet janë burimet kryesore të shkruara që përmbajnë elementet themelore të besimit Bektashian. Erqannamet kanë një vend të rëndësishëm për identifikimin dhe analizimin e elementeve të riteve të besimit Bektashian. Kodet që ndodhen e Erqanname kanë një rëndësi të veçantë sepse përveç përcaktimit të mënyrës se si duhet të kryhen ritet fetare ato përcaktojnë dhe rregullojnë jetën sociale të pjesëtarëve të këtij tarikati. Si rrjedhojë edhe pikëpamjet që kanë Bektaşjtë për mënyrën se si e konceptojnë jetën është e pasqyruar në këto shkrime prandaj dhe fitojnë një rëndësi më të madhe.

Në këtë shkrim është studiuar Erqannamja që ndodhet në Bibliotekën e Ataturkut që ndodhet në Bashkinë e Stambollit e Regjistruar në dosjen nr. OE. 1056 që ka titullin; “Kopja e Erqannames e madhërisë të nderuar Baba Hacı Kırzâde Hüsnî (Haxhi Kërzase Hysni) e Postnishi i Dergjahut Baba Halil İbrâhîm (Halil Ibrahim) në Tire në lagjen Hasan...” Erqannameja e përket Hilife Baba Hacı Kırzade Hüseyin Hüsnü i cili është postnishi i teqësë Arappınarı (Faltorja e Baba Halil Ibrahimit nga Horosani). Mendohet se vepra është kopjuar në vitet 1890-1893. vepra përbëhet nga 20 fletë gjithesej nga 40 faqe. Disa fletë janë lidhur më vonë por megjithatë në fund të veprës nuk ka asnjë datë. Erqannameja e studiuar, ka një tipar të rëndësishëm pasi ajo përmban të përshkruar me hollësi ritet e xhemit dhe veçanërisht të xhemit të rrëfimit. Në faqet e fundit gjenden disa përkthime dhe regjistrime të pavaruara nga Erqannameja.

Fjalët Kyçe:

Erqanname, Teqja Arappınarı, Baba Huseyin Hüsnü, Bektashizmi.

³ Universiteti Gazi, Instituti i Shkencave të Edukimit, nxënës Doktrature në degën Gjuha dhe Letërsia Turke, Ankara/ Turqi

⁴ Dr. Universiteti Balıkesir, Fakulteti i Edukimit, Dega e Edukimit të Turqishtes, Balıkesir/ Turqi

POEZIA DHE RITET NË MALET KAZDAĞA: MBI TRADITAT E TYRK-MENËVE TAHTACI (Tahtaxhë) SAZANDAR (Person që i bie Sazës dhe thot vjersha Aleviane)/ ZIKRIT.

Halil İbrahim ŞAHİN⁵

PËRMBLEDHJE

Dihet që Tyrkmenët Tahtacı që rrojnë në malet Kazdağa janë aleviane dhe si rrjedhojë aplikojnë disa rite të tilla. Ashtu si edhe në fiset e tjera Aleviane që ndodhen në Anadolli edhe për Tyrkmenët Tahtacı ceremonitë e zhvilluara në shtëpitë e Xhemit kanë një rëndësi të veçantë për jetën sociale dhe atë fetare. Ceremonitë e xhemit zhvillohen në disa kohë të caktuara të vitit ose kur për arsye të vecanta ndihet e nevojshme dhe disa persona kanë detyrë të bëjnë shërbim. Po të shprehemi më qartë; që ceremonitë e xhemit të kryhen si duhet dhe sipas rregullave disa njerëz duhet të zbatojnë detyrat e tyre. Në ceremonitë e xhemit pas Dedesë një pjesë e pandarë janë dhe Sazandarët/Zikëruesit. Këta persona që nën shoqërimin e sazës (vegël muzikore) thonë nefese (vjersha aleviane) nuk marrin pjesë vetëm në ceremonitë e Xhemit. Ata marrin pjesë dhe kanë një rol aktiv edhe në ceremonitë si prerja e kurbanit ose adakut (zotimit), përcjelljen e ushtarëve, në dasma në ceremoninë e “lidhjes së kokës” së nuseve, pas vdekjes në ceremonitë e vajtimit të të vdekurve, në festimet e Hidirelezit, në vizitat në Sarıkız (Sarëkëz) ose në lutjet për shërimin e të sëmurëve. Në këtë artikull është studiuar tradita Sazandarëve /Zikëruesve Tyrkmen Tahtacı të cilët jetojnë në pjesën e malit Kazdaği që është brenda kufirit të rrethit Balıkesir (Balëkesir). Në këtë artikull është humultuar edukimi i Sazandarëve dhe se si kalojnë në profesionalizëm, ambjendet dhe koha kur e ushtrojnë atë, përmbajtja, forma dhe struktura e vjershave që thonë, detyra që Sazandarët sipërmarrin në jetën shoqërore dhe atë fetare si dhe gjendja aktuale e kësaj tradite.

Fjalët Kyçe:

Kazdağ, sazandar, Zikir, Tahtacı, Alevizëm.

⁵ Ass. Doç Dr., Universiteti Balıkesir, Fakulteti i Shkencave dhe Letërsisë, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Turke, Balıkesir. hsahin@balikesir.edu.tr

KOMUNITETET NDËRKOMBËTARE: EMIGRANTËT ALEVIANË NË EUROPE

Deniz Cosan EKE

PËRMBLEDHJE

Nuk ka vend për asnjë dyshim që Europa është kthyer në shtëpinë e shumë grupeve të ndryshme emigrantësh që u përkasin feve dhe kulturave të ndryshme. Një nga banorët e kësaj shtëpie janë edhe meigrantët myslimanë, megjithëse ata kanë një vend shumë të diskutueshëm identifikimi Euro-Islam është një pjesë e kulturës së Europës që nuk duhet lënë pas dore. Si përfundim 20 milion nga 500 milionë njerëz që jetojnë në Bashkimin Europjan përbëhet nga popullsia e emigrantëve myslimanë dhe e myslimanëve të lindur në Europë. Islami e cila pranohet si një fe botërore brenda saj nuk e ka të detyrueshme të përmbajë të njëjtat karakteristika kulturore ose të njëjtat rituale. Kjo për arsye se në botë egzistojnë ndarje si grupet “heterodokse” ashtu edhe ato “ortodokse” të cilat megjithëse kanë rituale dhe besime të ndryshme e përkufizojnë besiminë ti tyre si besim Islam. Në këtë artikull është hulumtuar besimi Alevian që futet në sistemin heterodoks të Islamit. Alevitë si një popullsi kulturore dhe fetare megjithëse më shumë janë të vendosur në Turqi me rritjen e problemit të emigrimit ndërkombëtar mund të përkufizohet si një bashkësi ndërkombëtare. Si përfundim qëllimi i këtij studimi është studimi i ndikimit të kulturës Evropiane mbi Identitetin Alevian dhe vendi i saj në Evropë duke qenë se ajo është një komunitet që i përket Kulturës heterodokse Islame.

Fjalët Kyçe:

Komunitet ndërkombëtar, Emigrim, Identitet, Emigrantët Alevianë në Evropë.

DY KOMUNITETE TË NDYSHME DHE NJË PARAARDHËS I PËRBASHKËT: VIZITAT NË TURBEN PASHA (Shembulli I Synnive nga Ayaş (Ajashi) dhe Tahatacı (Tahtaxhit) nga Erdemli- Tömük)

Ali SELÇUK

PËRMBLEDHJE

Në temën e këtij artikulli është studimi dhe kodifikimi simbolik i shembullit të vizitave të Teqesë Pasha duke nxjerë në pah prirjet e besimit brenda fenomenit të kultit të heronjve. Vihet re që pavarësisht nga të gjitha ndryshimet që shkaktohen si pasojë e jetesës në komunitet dhe procesit kulturor, themeli i vlerave kulturore të këtij sistemi dhe komponentet kyçe janë ruajtur me ndryshimin e formës. Qëllimi i studimit është vlerësimi i ndryshimit ose ruajtjes së kësaj kulture duke studiuar shembujt e vizitave në dy Tyrbe. Ritet e vizitës, u morrën si baza e dimensionit simbolik të sistemit të vlerave duke formuar kështu edhe pikënisjen e këtij studimi. Ndikimet e Kulturës dhe besimit Atalar që i mban të bashkuar komunitetet vihet re shumë qartë në shembullin e Synnive në Ayaş dhe Tahatacıt Erdemli- Tömük. Pavarësisht se janë dy sisteme të ndryshme besimi ai Synni dhe ai Alevian të dy komunitetet heroin që prehet në Tyrben Pasha e pranojnë si paraardhësin e tyre, besojnë se ky hero ka bërë të mundur që rejonin ku ato jetojnë të jetë vendi i tyre dhe ruajnë e e respektojnë besimin dhe aplikojnë rituelin ndaj kultit të këtij paraardhësi. Paraardhësi që prehet në Tyrbe ka një personalitet të rëndësishëm në histori dhe pavarësisht se kanë botëkuptime të ndryshme për formën e riteve që zhvillohen rreth tyre që të dy komunitetet personalitetin karizmatik që prehet në tyrben Pasha e konsiderojnë si paraardhësi më i vjetër i tyre duke u bashkuar në këtë pikëkëpamje kulturore të përbashkët. Ky studim është kryer në lagjen Akdeniz në Erdemli si dhe në qytezat e Tömük dhe Ayaş duke përdorur mënyrën nitelike të studimit. Në këtë studim janë marrë bazë të dhënat e mbledhura gjatë studimeve të bëra në teren në vitet 2013-2014, të cilat janë mbledhur gjatë vëzhgimeve si pjesëmarrës dhe me intervista të hollësishme. Të dhënat e mbledhura janë analizuar dhe interpretuar me shumë kujdes.

Fjalët Kyçe:

Tahtacı, vizitë, manifestimi i shenjtë, Kulti i Paraardhësve heronj.

KRAHASIMI I APLIKIMEVE BESIMTARE TË ALEVIVE TË RRETHIT

ESKİŞEHİR (Eskishehir) DHE RAJONIT ÇUBUK

Doç. Dr. M. Sezai TÜRK⁶

Ass. Doç Dr. Ahmet BIYIK⁷

Ahmet GÜVEN⁸

Ayşe İŞİ⁹

PËRMBLEDHJE

Në këtë artikull duke krahasuar Alevitë e rrethit të Eskişehir(Eskishehirit) me ato të Rajonit të Çubukut në rrethin e Ankarasë jemi munduar të hulumtojmë se si konsiderohen dhe aplikohen nga shoqëritë vlerat aleviane. Më qëllim që të identifikohet saktësisht praktikimi aktual i vlerave aleviane në fshatrat e banuara nga alevitë në këto rajone është përdorur teknika studimit në terren. Për arsye së në regjistrat e popullsisë nuk ka një numër të saktë për popullsinë alevian me qëllim të lehtësimit të studimeve është përdorur mënyra e “topit të borës” për formimin e shembujve. Që shembujt të kenë vlerë universale ato janë përzgjedhur në shtëpitë e xhemit ose me ndihmën e Kryepleqve dhe në Çubuk u arrit të kontaktohet me 438 njësi shembujsh e për studim u përdorën mënyra e anketës dhe e bisedimeve ballë përballë. Pasi janë hequr anketat ku ka vërejtje të mangëta kanë ngelur 420 anketa që janë konsideruar. Duke përdorur të njejtën mënyrë – topi i borës- të përpilimit të shembujve për rrethin e Eskishehirit janë bërë 750 anketa. Por pasi pjesëmarrësit e në anketa kanë dhënë përgjigje të mangëta dhe kanë patur vërejtje të mangëta numri i anketave të konsideruara është 408.

Në rajonin e Çubukut në 20 fshatra janë bërë 420 anketa të plotësuar nga shtetasit alevianë dhe në këtë studim materialet janë grupuar në disa kategori me qëllim përcaktimin e aplikimeve fetare të alevive. Po në të njejtën mënyrë edhe në fshatrat aleviane të Eskishehirit janë anketuar 408 Fshatarë. Dhe të dhënat e marra nga këto shembuj janë krahasuar me ato të marra nga rajoni i Çubukut.

Nga shembujt e marë dhe të studjuara doli që në të dy këto rajone njihen vlerat dhe konceptet aleviane dhe ëe jetën praktike këto koncepte kanë një vend të rëndësishëm.

Fjalët Kyçe:

Alevizmi, Kërkues, Xhem, Besimtar

⁶ Universiteti Gazi, Fakulteti i Komunikimit, Pedagog

⁷ Universiteti Gazi, Shkolla e Lartë Profesionale, Pedagog

⁸ Universiteti Gazi, Shkolla e Lartë Profesionale, Pedagog

⁹ Universiteti Gazi, Shkolla e Lartë Profesionale, Pedagog

TRADITA E KRYEPËRIT (SERÇEŞME – Serçeshme-) NË ALEVIZËM

Veli SALTİK

PËRMBLEDHJE

Një traditë shumë e rëndësishme që ka gati 1200 vjet që vazhdon është “Tradita Imamët”.

Tradita e Imamëve fillon me Hz. Aliun; pas vrasjes së Hz. Aliut i kaloi të birit Hz. Hasanit. E pasi u vra dhe ky i fundit Imamlliku i kaloi birit të dytë Hz. Hysejnit. Kur Hz. Hysejni ra dhëshmor në Qerbela Imamlliku i kaloi djalit të vetëm që akoma jetonte Zejnel Abidinit.

Më vonë sipas traditave Sejrite Imamlliku gjithmonë kaloi nga Babai tek djali i madh.

Kur Imami ndoronte jetë në vend të tij kalonte djali i madh. Vëllezërit e tjerë e pranonin Imamllikun pa asnjë lloj kundërshtimi.

Por kjo traditë një herë u ngatërua dhe atëherë përkrahësit e Aliut u ndanë në dy grupe. Djali i madh i Imam Xhaferit ndroi jetë para tij. Prandaj dhe ai la emanet që pas vdekjes së tij Imamlliku ti kalojë djalit të tij të dytë Musa Qazimit. Por përkrahësit e Aliut që janë një grup i rëndësishëm thanë; “Vërtet biri i madh i Imam xhaferit, Ismaili ndori jetë para tij, por ai ishte i martuar dhe kishte një djalë me emrin Muhammet Matkum. Megjithatë ai është fëmijë Imamlliku është haku i tij.” Dhe se njohën Imamllikun e Ismailit e si rrjedhojë dhe të djalit të tij Muhammet Matkumit. Atyre u thuhet “Ismailët” osë “7 imamët”. “Fatimët në Egjipt dhe Nazaritët në Iran janë nga ky grup. Imami i tyre i fundit është Ağa Han.

Shumica e mbështetësve të Aliut (mbështetësit e Ehli Bejtit), duke respektuar emantin e Imam Xhaferit njohën Imam Musa Qazimin. Alevitë dhe Shiitë janë nga ky grup.

Sejritët që vijnë nga gjaku i Hz. Aliut dhe Hz. Muhammetit kur arritën në atë pikë që s’mund të rronin më në botën Arabike u shpërngulën për në shtetin e Turqisë. Një pjesë e rëndësishme e tyre u shkrinë me Turqit dhe u Tuqizuan. Kështu që edhe tradita e Imamllëkut u Turqizua dhe u kthye në traditën e Kryepirit (Serçeshme).

Në vitin 874 në qytetin e Nishaburit në Iran/Horosan u themelua qendra e Kryepirit, pas pushtimit Mongol në vitin 1220 me ndihmën e pirit të Fundit Pir İlyas, Degjahu i Nishaburit u shpërngul në Çatköy (Çatkoj) në Amasya (Amasja). Në vitin 1240 në “Kryengritjen Babai” Pir İljas dhe tre djemtë e tij u varën e pas kësaj; Kryepiri (Serçeşme) i kaloi birit të fisit të dytë shumë të rëndësishëm që ishte Haxhi Bektash Veliu.

Fjalët Kyçe:

Alevizmi, Tradita e Imamllikut, Kryepiri, Serçeşme

